



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Sesioni pranveror

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Mbledhja nr.54

Prishtinë, me 02 maj 2019, në orën:10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Xhevahire Izmaqi, Imet Rrahmani, Rasim Selmanaj, Albert Kinolli, Imet Rrahmani, Milaim Zeka, dhe Jasmina Zivkovic
Mungoi: Adem Mikullovi, Shqipe Pantina, Valon Ramadani dhe Arban Abrashi.

Në mbledhje morën pjesë: dy anëtarë të Bordit të RTK-së, përfaqësuesit e OSCE-së.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Drita Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Nait Hasani, kryetar i komisionit.

Rendi i ditës

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i Raportit vjetor të Komisionit të Pavarur për Media, për vitin 2018;**
- 3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Radio Televizionit të Kosovës, për vitin 2018;**
- 4. Shqyrtimi dhe miratimi i draftligjit për Kuvendin e Republikës së Kosovës;**
- 5. Të ndryshme.**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

- 2. Miratimi i Raportit vjetor të Komisionit të Pavarur për Media, për vitin 2018;**

Nait Hasani, propozoi që raporti të miratohet, pasi që pas diskutimeve, vërejtjeve të anëtarëve të komisionit, nga mbledhja në të cilën u shqyrtua raporti i KPM-së, komisioni kishte kërkuar informata shtesë për të cilat KPM-ja i ka dërguar të gjitha dokumentet për plotësimin e raportit, të gjithë anëtarëve të komisionit.

Konstatim: Komisioni me 5 vota “Për”, 1 “Kundër” dhe 1 “ Abstenim”, miratoi Raportin vjetor të Komisionit të Pavarur për Media, për vitin 2018, dhe nxori këtë,

Rekomandim

1. Të miratohet Raporti vjetor i Komisionit të Pavarur për Media, për vitin 2018.
2. Arsyetimin e Raportit me rekomandime e paraqet, deputeti Nait Hasani, kryetar i Komisionit.

Arsyetim

Në bazë të nenit 3, paragrafi 2, pika 8, të Ligjit nr. 04/L-44, për Komisionin e Pavarur për Media, KPM-ja ia paraqet Kuvendit të Republikës së Kosovës deri me 31 mars të vitit vijues, një raport vjetor, duke përfshirë edhe të dhënat e plota në lidhje me përcaktimin dhe zbatimin e politikës së transmetimit, dhënien e licencave dhe të ankesave, sanksionet që zbatohen dhe vendimet në lidhje me to, aktivitetet financiare, aktivitetet e tjera të transmetimit si dhe objektivat për vitin e ardhshëm. Raporti vjetor duhet të bëhet publik, pas miratimit nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, në mbledhjen e mbajtur më 10.04.2018, nuk e ka miratuar raportin me kërkesën që raporti të plotësohet nga KPM-ja, me vërejtjet e anëtarëve të Komisionit. Komisioni në mbledhjen e mbajtur më 02.05.2019, rishqyrtoi Raportin vjetor të Komisionit të Pavarur për Media me plotësimet shtesë, dhe vlerësoi se i njëjti i përmbush obligimet ligjore për raportim dhe Kuvendit i rekomandon miratimin e tij.

3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Radio Televizionit të Kosovës, për vitin 2018;

Kryetari i komisionit e njoftoi komisionin se Transmetuesi Publik, ka sjell raportin brenda afatit të paraparë me ligjin për RTK-në , dhe për te prezantuar punën e RTK-së ia kaloi fjalën kryetares së Bordit.

Afërdita Maliqi, duke prezantuar raportin për vitin 2018, njoftoi komisionin se Radiotelevizioni i Kosovës në vitin 2018, ka kryer të gjitha obligimet, duke zbatuar me përpikëri ligjin në fuqi dhe rregullativat tjera ligjore.

RTK ka arritur jo vetëm ta mbajë shkallën e shikueshmërisë, por edhe ta pasurojë përmbajtjen në shumë aspekte, përkundër ambientit mjaft të vështirë për ta ushtruar veprimtarinë e vet, duke marrë parasysh gjendjen e rënduar financiare, pastaj mjediset krejtësisht të papërshtatshme për punë.

Duke qenë transmetues i veçantë dhe i vetmi që nuk funksionin në baza thjeshtë komerciale e as të profitit, por duke përmbushur misionin e vet kushtetues, ligjor dhe shoqëror, si transmetues

publik multietnik, në radio, në televizion, në web faqe, edhe në sektorët e tjerë përcjellës, janë në përdorim zyrtar të gjitha gjuhët e komuniteteve të Kosovës.

Buxheti i ndarë për RTK, për vitin 2018, ishte 11.2 milionë euro nga buxheti i shtetit dhe një pjesë nga reklama, dhe ky vit është përmbyllur pa humbje, pavarësisht buxhetit të vogël. Auditori i jashtëm i Pavarur për pasqyrat financiare të RTK-së për vitin 2018, ka dhënë opinion të pakualifikuar që tregon se buxheti është menaxhuar në mënyrën e duhur. Por, mungesa e buxhetit adekuat që do t'i plotësonte nevojat reale të Transmetuesit Publik ka bërë që shumë ide e projekte radiotelevizive të mbesin pa u realizuar.

RTK, është përpara sfidave të shumta, duke filluar nga çështja e borxhit të bartur ndër vite që po shkakton probleme pikërisht në realizimin e veprimtarisë së përditshme, pasi që mjetet e dedikuara për një qëllim gjatë vitit vijues, duhet të paguhen për borxhe të viteve paraprake

Pyetjet e anëtarëve të komisionit lidhur me raportin

Xhevahire Izmaku, vlerësoi raportin e punës së RTK-së, si raport të funksionimit të mirë të RTK-së, ndërsa pati vërejtje rreth përzierjes së punëve në mes gazetarëve dhe propozoi se tek skema programore – tha se programet arsimore kanë vend për përmirësim, në kontekst të plotësimit të programeve arsimore me prezentimin e punëve shkencore të studentëve kosovar të cilët studiojnë jashtë Kosovës.

Rasim Selmanaj, tha se janë të njoftuar me problemet dhe sfidat e RTK-së, por derisa politika bënë thirrje për një transmetues publik të pavarur nga politika, kjo e fundit është vet ajo që e mban peng draft/ligjin për RTK-në duke mos e votuar në Kuvend.

Milaim Zeka, tha se në raport nuk është inkorporuar çështja e produksioneve të jashtme të cilat menaxhmenti i RTK-së vazhdon t'i konsideron si të jashtme, ndërsa që fakti është se çdo produksion i emetuar nga RTK është produkt i RTK-së dhe përgjegjësinë autoriale për transmetimin e tyre e ka vetëm RTK, lidhur me këtë, ai kërkoi nga bordi të merret me shqyrtimin e çështjes. Gjithashtu, ai kërkoi sqarim për zërimin e dobët gjatë emetimit të programeve , emetimit të emisionit “Debat”- me persona të njëjtë.

Sa i përket finacave, pyeti se cila është logjika që RTK-ja me gjithë borxhet që ka të ndajë projekte për persona të caktuar me vlerë prej qindra –mijëra euro, ndërsa që menaxhmenti i RTK-së ka refuzuar të nënshkruajë kontrata për produksionet që ofertuesit i kanë ofruar pa pagesë. Ai kërkoi nga anëtarët e komisionit përkrahje, me qëllim të funksionimit më të mirë të RTK-së dhe zgjedhjes permanente të problemit të pronës së RTK-së, Kuvendi të nxjerr vendim për lirimin e objektit aktual të RTK-së dhe ndërtimin e një studio moderne në pjesën e objektit tjetër të RTK-së, në aneks.

Imet Rahmani, tha se diskutimi i parafolësit vetëm që e ka forcuar bindjen çka të gjithë mendojnë për transmetuesin publik. RTK ka hyrë në grackë si garuese për shikueshmëri në raport me mediat komerciale, në vend që të përmbush shikueshmërinë në interes të publikut, ajo emeton programe vetëm sa për klikime që nuk garantojnë cilësi dhe nuk janë kontributdhënëse për shoqërinë.

Pyetja e tij ishte, sa përqind është mungesa e programeve edukativo - arsimore në raport me vitet paraprake dhe a është aprovuar nga bordi skema programore?

Albert Kinolli, tha se, RTK në emetimin e programeve për komunitetet jo shqiptare, jo serbe është shembulli më i mirë i funksionimit të një transmetuesi publik në rajon.

Aferdita Maliqi, u përgjigj në pyetjet e deputetëve,

- RTK-ja ka hartuar planin për ndryshimin dhe plotësimin e skemës programore, sidomos në zëvendësimin e programeve debat me ato edukativo – arsimore, por për një vendim i tillë nuk është nënshkruar nga ushtruesi i detyrës së drejtorit të RTK-së, me arsyen për mos marrje të përgjegjësisë deri në zgjedhjen e drejtorit.

- Sa i përket emetimit të programeve me zërim të dobët, çështja është diskutuar në dy mbledhjet e bordit, përgjigja e menaxhmentit ka qenë se problemi është tek KTTN-ja.

- Për çështjet financiare, borxhet që RTK-ja i ka, janë borxhe të trashëguara nga viti 2010-2011, të cilat janë krijuar nga kontratat e mëhershme që kanë qenë të disfavorshme për RTK-në, të gjitha janë të publikuar në adresën elektronike nga auditori i përgjithshëm.

Vlen të theksohet që borxhi i RTK-së është i njëjtë domëtenëh nuk është rritur e as zvogëluar, por që RTK-ja pret vendimet e përmbaruesit në raport me kontraktuesit.

Imet Rrahmani, pyeti: a ka indikacione për falje të borxhit apo kjo çështje kuptohet si tentim për moskthim të borxhit?

Nëse përmbaruesi do të ekzekutojë vendimet e gjykatës që obligon RTK-në të kthejë borxhet, atëherë RTK-ja dëshmon se ka dështuar në kthim të borxhit, së paku në zvogëlim të borxheve.

Konstatim: Komisioni, me 5 vota “Për”, 1 ”Abstënim” (Imet Rrahmani nuk ka marrë pjesë në votim), miratoi Raportin vjetor të Transmetuesit Publik, për vitin 2018, dhe nxori këtë,

R e k o m a n d i m

1. Të miratohet Raporti vjetor i Radiotelevizionit të Kosovës, për vitin 2018.
2. Arsyetimin e Raportit me rekomandime e paraqet, deputeti Nait Hasani, kryetar i Komisionit.

Arsyetim

Në bazë të nenit 21, paragrafi 6, pika 1 dhe të nenit 38.4 të Ligjit nr. 04/L-046 për Radiotelevizionin e Kosovës, Radiotelevizioni i Kosovës ia dorëzon Kuvendit raportin vjetor të aktiviteteve jo më vonë se 31 mars, si dhe raportin vjetor për debatin publik dhe të mendimit të Bordit të RTK-së për qëllime orientuese.

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, në mbledhjen e mbajtur më 02.05.2019, shqyrtoi Raportin vjetor të Radiotelevizionit të Kosovës, dhe vlerësoi se i njëjti përmbush obligimet ligjore për raportim dhe Kuvendit i rekomandon miratimin e tij.

4. Shqyrtimi dhe miratimi i draftligjit për Kuvendin e Republikës së Kosovës;

Nait Hasani, tha se për hartimin e draftligjit për Kuvendin, komisioni për bazë ka marr tekstin e hartuar në legjislaturën e kaluar nga Komisioni Parlamentar për Legjislacion dhe Projekti i Binjakëzimit.

Konstatim: Komisioni miratoi unanimitisht P/ligjin dhe kërkoi nga administrata që të procedojë për mendim në Qeveri sipas rregullave të përcaktuara me rregulloren e Kuvendit.

5. Të ndryshme

Nait Hasani, njoftoi komisionin për skadimin e mandatit të dy anëtarëve të Bordit për Ankesa të Mediave me 16 qershor, sipas ligjit për KPM-në, konkursi është dashur të hapet nga Kuvendi 60 ditë para skadimit të mandatit, që do të thotë me 16 prill 2019. Lidhur me këtë, ai propozoi që komisioni të merrë vendim për shpalljen e konkursit për dy anëtarë të Bordit për Ankesa të Mediave.

Konstatim: Komisioni unanimitisht votoi për nxjerrjen e Vendimit

Në mbështetje të nenit 38 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Ligjit nr. 04/L-044 për Komisionin e Pavarur të Media, Komisioni nxori këtë,

V E N D I M

1. Shpallet konkursi për zgjedhjen e anëtarëve për Bordin për Ankesa të Mediave në pajtim me kushtet e parapara me Ligj.
2. Publikimi bëhet në mediat e shkruara dhe elektronike.
3. Konkursi mbetet i hapur 15 ditë, nga dita e publikimit në mediat e shkruara dhe elektronike.

4. Ngarkohet Administrata e Kuvendit t'i marrë veprimet e nevojshme për shpalljen e konkursit dhe pranimin e aplikacioneve.

Kryetari i komisionit,

Nait Hasani